




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. _____	Nr Prot _____
Dep. _____	B: Prot _____
Dep. <u>70</u>	Prot No <u>01-143/15</u>
Nr. i faq _____	Data _____
Broj stranica _____	Datum <u>21.01.2015</u>
Nr. pages <u>02</u>	Date _____
PRISHTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 20.01.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK- 03-4257/14, për znj. Makfire Osmani – Anëtare e Bordit në Kompaninë për Menaxhimin e Deponive, për arsye se e njëjta, tashmë, nuk e ushtron funksionin e personit të autorizuar në Kompaninë e Ujësjetës Rajonal “Prishtina”, prandaj nuk ka konflikt interesi.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik, nr. AKK – 03-4257/14, për znj. Makfire Osmani – Anëtare e Bordit në Kompaninë për Menaxhimin e Deponive është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në këtë rast zyrtarja e lartë znj. Osmani, është hetuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, si zyrtare e lartë në Kompaninë për Menaxhimin e Deponive dhe njëkohësisht person i autorizuar në Kompaninë e Ujësjetës Rajonal “Prishtina”.

Fillimisht zyrtarja e lartë është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit, ndërsa më pas është takuar me zyrtarët e Agjencisë për t'i sqaruar situatën në të cilën ndodhet dhe për ndryshimet që duhet të bëj, në mënyrë që të shmangë situatën e konfliktit të interesit.

Gjatë takimit znj. Osmani ka deklaruar se tashmë nuk bën pjesë në stafin menaxhues të ndërmarrjes “Prishtina” dhe për këtë ajo ka ofruar si dëshmi kontratën e saj të punës.

Këtë e ka konfirmuar edhe koordinatori për çështje juridike dhe praktike në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK), i cili ka thënë se Kompania “Prishtina”, me rastin e aplikimit në këtë Agjenci në vend se të aplikoj për ta bërë reregjistrimin ka aplikuar për regjistrim të ri. Në regjistrimin e ri, siç dëshmohet edhe nga të dhënat e ARBK-së zyrtarja e lartë Makfire Osmani nuk figuron si person i autorizuar.

Prandaj, duke pasur parasysh këto të dhëna, në këtë rast nuk ka konflikt interesi e as kufizim në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

